

TELEFONA MË TË RËNDËSISHËM

- LAMM(Lidhja auto-moto e Maqedonisë) - ndihmë në rrugë 196
- LAMM- qendra informative 9801
- AUTO-NDIHMË NË RRUGË (24 orë pa ndërprerje) 9159
- POLICIA 192
- INSPEKTORATI SHITËTËROR TREGTAR 975
- BRIGADA KUNDËR ZJARRIT 193
- NDIHMA E SHPEJTË 194
- QENDRA RAJONALE PËR ADMINISTRIM ME KRIZA 195
- DOGANA 197
- PARAQITJE TË KORRUPSIONIT NË POLICI 199

AMBASADA DHE PËRFAQËSI DIPLOMATIKE

Austria 02/3109-550,
Australia 00 381 11 624655 (Beograd),
Shqipëria 02/2614-636,
Belgjika 02/3136-209,
Bullgaria 02/3116-320, 02/3229-444,
Britania e Madhe 02/3299-299, 02/3109-941,
Gjermania 02/3093-900,
Greqia 02/3219-260,
Danimarka (+43-1) 5127904 (Vjen),
Italia 02/3236-500,
Irani 02/3217-420,
Japonia +43-1-53 192353 (Vjen),
Mali i Zi 02/3227-277,
Norvegjia 02/3129-165,
Polonia 02/3119-744,
Romania 02/3228-055, 02/3228-057,
Rusia 02/3117-160,
Sllovenia 02/3178-730, 02/3176-663,
SHBA 02/3116-180,
Turqia 02/3113-270,
Hungaria 02/3063-423, 02/3063-197,
Franca 02/3118-749, 02/3117-574,
Holanda 02/3109-250,
Kroacia 02/3127-350,
Zvicra 02/3103-330,
Suedia +381-11-2069200 (Beograd)

TË DHËNA TË RËNDËSISHMË PËR REPUBLIKËN E MAQEDONISË

Kryeqytet (dhe qytet më i madh) - Shkupi

42°0 N 21°26 E / 42°N 21.433°E

Gjuha zyrtare - Gjuha maqedonase

Sistemi - Republikë Parlamentare

- President Gjorgje Ivanov

- Kryeministër Nikolla Gruevski

Pavarësi nga Jugosllavia

- Pavarësia e shpallur më tetë shtator të vitit 1991

Sipërfaqja

- Sipërfaqja totale 25.713 km²

- Ujë (%) 1,9%

Popullsia

- Në vitin 2009 përafërsisht 2.114.550 banorë

- Dendësia e popullimit 82,2/km²

BPV (FVV/PPP) përafërsisht në vitin 2008

- Në total 18.818 miliardë USD

- Për banorë 9,157 USD

BPV/FVV (nominal) përafërsisht në vitin 2008

- Në total 9.569 miliardë USD

- Për banorë 4,656 USD

Valuta -Denar maqedonas (MKD)

- Zona kohore SET (UTC+1)

- Periudha e verës (DST) CEST (UTC+2)

Automjetet drejtohen në anën e djathtë të rrugës

Domeni nacional i internetit .mk

Prefiksi telefonik ndërkombëtar 389



VERSIONI
SHQIP


MIRË SE ERDHËT NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË



LEXO - MENDO – MBAJ MEND

INFORMATA TË
DOBISHME PËR
DREJTUESIT E
AUTOMJETEVE NË
RRUGËT E REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË





Në rrugët e Republikës së Maqedonisë është e detyrueshme ndezja e dritave, gjatë ditës dhe natës, në të gjitha rrugët, magjistrale, rajonale ose lokale si dhe në vendet e banuara.

MOSRESPEKTIMI I KËSAJ DISPOZITE LIGJORE SHOQËROHET ME DËNIM NË SHUMË PREJ 45 EUR.

Kufizimet e shpejtësive në rrugët e Republikës së Maqedonisë janë:

- 130 km/orë në autostradë,
- 110 km/orë në rrugë të rezervuar për automjete,
- 60 km/orë në vende të banuara.

MOSRESPEKTIMI I KËSAJ DISPOZITE LIGJORE SHOQËROHET ME DËNIM NË SHUMË PREJ 45 DERI NË 300 EUR, NË VARËSI TË SHKALLËS SË TEJKALIMIT TË SHPEJTËSISË.

Është e ndaluar hedhja ose lënia e letrave, mbeturinave të cigareve, çamçëkizave, ambalazheve, dheut, mbeturinave të bimëve, rërës dhe mbeturinave të tjera, përveç në vendet e përcaktuara për atë qëllim. Është e ndaluar lenia e mbeturinave fekale të kafshëve shtëpiake.

Është i ndaluar parkimi i automjeteve në distancë deri në dhjetë metra nga kontejneri.

NË RAST TË MOSRESPEKTIMIT TË NDONJË NGA NDALESAT E SIPËRPMENDURA KUNDËRVAJTËSI DO TË DËNOHET ME GJOBË PREJ 50 EUR.

- Në rastet kur bëhet shkelje të ndonjë dispozite të ligjit për qarkullim dhe faturohet gjobë (dënim), të njëjtën duhet ta shqiptoj polic me uniformë, por gjoba paguhet në bankën ose postën më të afërt. Nuk lejohet që pagimi i gjobës të bëhet në vendin e ngjarjes, nga ana e policit me uniform.

ËSHTË E NDALUAR QË PAGESA E GJOBËS TË BËHET NË VENDIN E NGJARJES NË KESH, NGA POLICI ME UNIFORMË. NË RAST TË INSISTIMIT QË GJOBA T'I PAGUHET POLICIT ME UNIFORMË, JENI TË DETYRUAR NGJARJEN TA DENONCONI NË STACIONIN POLICOR MË TË AFËRT.

- Në Republikën e Maqedonisë është i detyrueshëm përdorimi i rripit të sigurimit për të gjitha pasagjerët, në të gjitha sediljet ku ka rrip sigurimi.

MOSRESPEKTIMI I KËSAJ DISPOZITE LIGJORE SHOQËROHET ME GJOBË PREJ 20 EUR.

- Limiti i sasisë së lejuar të alkoolit në gjak është 0,5 promilë.

- Tek drejtuesit profesional të automjeteve NUK LEJOHET prania e alkoolit në gjak. Limiti është 0,0 promilë.

MOSRESPEKTIMI I KËSAJ DISPOZITE LIGJORE SHOQËROHET ME GJOBË PREJ 250 DERI NË 400 EUR, NË VARËSI TË TEJKALIMIT TË PËRQINDJES SË ALKOOLIT NË GJAK. NË RAST SE KONSTATOHET PËRQIDJE MË E MADHE E ALKOOLIT NË GJAK NGA AJO QË ËSHTË E PËRCAKTUAR ME LIGJ, DREJTUESI I MJETIT DO TË PËRJASHTOHET NGA QARKULLIMI.

- Në sediljen e parme të pasagjerit nuk duhet të udhëtojnë fëmijë deri në moshën 12 vjeçare dhe persona të cilat janë në gjendje të alkoolizuar.

MOSRESPEKTIMI I KËSAJ DISPOZITE LIGJORE SHOQËROHET ME GJOBË PREJ 45 EUR.

- Drejtuesi i automjetit nuk duhet të përdor celular gjatë drejtimit.

MOSRESPEKTIMI I KËSAJ DISPOZITE LIGJORE SHOQËROHET ME GJOBË PREJ 45 EUR.

Posedimi dhe mbajtja e pajisjeve dimërore është e detyrueshme në periudhën nga 15 nëntor deri në 15 mars.

MOSRESPEKTIMI I KËSAJ DISPOZITE LIGJORE SHOQËROHET ME DËNIM NË SHUMË PREJ 15 EUR.

Personat e huaj të cilët nuk i përdorin shërbimet e personave fizik ose juridik që ofrojnë shërbime akomodimi me pagesë ose të personave të tjerë, janë të obliguar vetë ta paraqesin qëndrimin e tyre në Ministrinë e Punëve të Brendshme, në afat prej 24 orë nga ora e kalimit të kufirit shtetëror.

GJOBË NË SHUMË PREJ 600 DERI NË 1.000 EUR DO T'I SHQIPTOHET PERSONIT TË HUAJ PËR KUNDËRVAJTJE I CILI NUK DO TA REGJISTROJË OSE ÇREGJISTROJË QËNDRIMIN E TIJ.

